

AKTI I THEMELIMIT

I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA

«STARLINK» Sh.p.k.

Neni 1 Emertimi i Shoqerise

Sot, në Tiranë në datën 22 Korrik 2021 me vullnetin e lirë Ortakët e Shoqërise:

Shoqëria “STARGATE” Sh.p.k. me NIPT L72218034K me seli në Bulevardin “Zogu i Parë”, Qendra Tregtare Tirana, Godine Shumekateshe banimi dhe sherbimi, kati i peste, Tiranë, dhe

Shoqëria “JOENA” Sh.p.k. me NIPT K72022032H dhe me seli në Rruga “Frederik Shiroka”, Ndertesë Nr.4, Hyrja Nr.4, Njesia Nr.7, Tiranë,

Vendosën: të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar emërtimi i së cilës do të jetë «STARLINK» Sh.p.k.

Neni 1 Selia e Shoqerise

Shoqëria do ta ketë seline e saj në qytetin e TIRANES, Njesia Nr.7, Rruga Frederik Shiroka, Ndertesë Nr.4, Hyrja Nr.4, por me Vendimin e Asamblese së Ortakeve, mund të ngrihen edhe dege, filiale apo dhe seli në vende të tjera, brenda dhe jashtë territorit të Shtetit Shqiptar.

Neni 2 Kohezgjatja e Veprimtarise

Kohezgjatja e veprimtarise do të jetë 10 vjet të njepasnjeshem, por me Vendim të Asamblese së Ortakeve, ky afat mund të ripërterihet.

Neni 3 Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërise perbehet nga 100.000 (njqindmije leke), i ndare në 2 kuota, i cili është teresisht kapital financiar e perbehet nga kontributi i ortakeve si me poshte:

Shoqëria “STARGATE” Sh.p.k., zoteron një kuote e njesuar me 50% të kapitalit, me vlerë nominale të barabarte me 50.000 Leke (pesëdhjetë mijë lekë).

Shoqëria “JOENA” Sh.p.k., zoteron një kuote e njesuar me 50% të kapitalit, me vlerë nominale të barabarte me 50.000 Leke (pesëdhjetë mijë lekë).

Ortakët kanë të drejtë ta tjetërsojnë këtë kapital, të shtojnë apo të pakësojnë kuotat e kapitalit deri në kufijtë e përcaktuara nga ligji.

Neni 4 Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së kësaj Shoqërie do të jetë:

- Aktiviteti në fushën e tregtisë: Import - Eksport si dhe tregti me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm të lejuar nga ligji, mallrave ushqimore dhe industrial, të materialeve të ndërtimit, hidrosanitare, hidraulike, makinave dhe automjeteve të tonazheve të ndryshme, pllakave të të gjitha llojeve, plastike, gomes, lendeve drusore dhe mobiljeve, linjave të prodhimit dhe përpunimit, makinerive të llojeve dhe tonazheve të ndryshme, por pa u kufizuar vetëm në këto, por edhe mallrave tregtimi i të cilave kërkon licencë të vecantë si dhe importimin e lendeve të parë për prodhim. Shitblerje të artikujve joushqimore, detergjente, materiale pastrimi, etj.
- Aktiviteti në fushën e marketingut: Funksione të agjencit të shitjes për shoqëri vendase dhe të huaja, duke hapur degë apo zyrë në vende të huaja për arritjen e objektivave të shoqërisë, duke kryer të gjitha veprimet që lidhen me këtë veprimtari.
- Transport për vetë dhe të tjerë, nacional e internacional.

Me zgjerimin e aktivitetit, shoqëria mund të bëjë shtesë të ndryshme ose ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj, duke bërë ndryshimet përkatëse në Status.

Neni 5 Organet Drejtuese të Shoqërisë

Organet e Shoqërisë janë:

1 – *Asambleja e ortakëve* e cila përbëhet prej dy ortakëve themelues.

2- *Administratori* i deleguar i shoqërisë do të jetë Z. Bilbil Laçi, me shtetësi shqiptare, i cili do të përfaqësojë shoqërinë «STARLINK» Sh.p.k., në marrëdhënie me të tjerët për një afat 5 (peshë) vjeçar .

Neni 6

Shperberja dhe likuidimi

Shoqeria shperbehet per arsyet e parashikuara nga ligji dhe me :

- a. per mbarimin e afatit
- b. per pamundesi te funksionimit ose per inaktivitet te vazhduar te asamblese
- c. per reduktimin e kapitalit nen minimumin ligjor.
- d. me vendim te asamblese se ortakeve dhe per arsye te tjera te parashikuara me ligj

Ne te gjitha hipotezat e shperberjes, asambleja e ortakeve, do te caktojë nje ose me shume likuidatore duke percaktuar numrin e likujduesve si dhe kriteret ne baze te te cilave do kryhet likuidimi.

Neni 7

E gjithe veprimtaria e shoqerise do te bazohet ne Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe ligji nr 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" si dhe ne Legjislacionin ne pergjithesi te Republikes se Shqiperise.

Neni 8

Ky Akt Themelimi u nenshkrua sot ne pese kopje te barazvlefshme te tij sot me daten 22 Korrik 2021 (njezete e dy korrik te vitit dymijë e njezete e nje) .

Asambleja e Ortakeve:

"STARGATE" Sh.p.k.

Bilbil Gaci



"JOENA" Sh.p.k.

FATRI KARBERI

